



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

UDHËZUES PËR APLIKANTËT

**ORGANIZATA RINORE DHE/OSE PËR TË RINJTË NË KUADËR TË THIRRJES SË
PARË PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME DEDIKUAR TË RINJVE**

1. Hyrje

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) krijuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 75/ 2019 “Për rininë”, VKM nr. 681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë” duke u bazuar në VKM nr. 1141 datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së Organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”, financon projektet e propozuara nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë që i referohen prioritetëve rinore të cilave i përmbahet kjo thirrje.

Përcaktimi i prioritetëve për këtë thirrje të parë bazohet në politikat e Qeverisë për Rininë, Strategjinë Kombëtare për Rininë, si dhe konsultimeve të bëra me Këshillin Kombëtar i Rinisë (KKR).

Ky udhëzues u vjen në ndihmë duke ofruar këshilla të qarta dhe duke orientuar mbi hartimin e dokumentacionit dhe procedurën e aplikimit të gjithë organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë që janë të interesuara për të paraqitur aplikimet e tyre referuar kësaj thirrje.



1.1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj thirrje është të mbështesë projektpropozimet nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë me synimin e impaktit të rinjtë.

1.2 Synimi i përgjithshëm i thirrjes së parë publike të Agjencisë Kombëtare të Rinisë i referohet projektpropozimeve të cilat i përmbahen këtyre prioriteteve:

- a) **Inovacioni dhe sipërmarrja:** duke synuar uljen e fenomenit të papunësisë tek të rinjtë përmes krijimit të mekanizmave mbështetës financiar, krijimit të lehtësirave të shkëmbimit të informacionit dhe burimeve të komunikimit dhe mbështetjes së programeve start-up, leadership-it apo ideve inovatore. Qëllimi i vetëm është rritja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës, orientimit përmes trajnimeve si dhe formave të tjera motivuese dhe mbështetëse për të zhvilluar më tej nismat dhe idetë e tyre të cilat do t'u shërbejnë jo vetëm të rinjve dhe të ardhmes së tyre por edhe komunitetit në të cilin jetojnë.
- b) **Vendimmarrja dhe gjithëpërfshirja:** përfaqësimi i të rinjve në jetën politike, forcimi i kapaciteteve rinore për advokim dhe gjithëpërfshirje në proceset e vendimmarrjes falë promovimit të të drejtave të tyre.
- c) **Edukimi jo-formal:** propozimi dhe ofrimi i metodave dhe mundësive të ndryshme nga sistemi formal arsimor me synimin për ti aftësuar të rinjtë me një sërë mjesh të nevojshme që janë në ndihmë të nevojave dhe interesit të të rinjve, vullnetarizmi dhe aktivizimi i të rinjve në proceset e të nxënies, aksesit në tregun e punës, zhvillimin e potencialit personal dhe kujdesi për mirëqënien e shëndetit të të rinjve.
- d) **Përfshirja sociale:** ky prioritet ka në fokus integrimin social dhe ekonomik të të gjithë target grupeve rinore, duke zbatuar parimin e barazisë gjinore dhe diskriminimit,



integrimin e grupeve të marginalizuara, të rinjve me aftësi ndryshe etj. Promovimin e vullnetarizmit, ndërgjegjësimit e të rinjve, nxitjen e sjelljeve të mira sociale duke evituar mundësitë e kriminalitetit dhe korrupsionit të rinjtë.

1.3 Fondet (Grantet) që janë në dispozicion për këto projekte

Për këto shuma grantesh kanë të drejtë të aplikojnë të gjitha organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë të cilat i përmbahen kriterëve të përcaktuara në vijim.

Totali i grantit për mbështetjen e organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë në këtë thirrje është 28.800.000 Lekë, i cili ndahet si më poshtë:

- Totali i Grantit në dispozicion të projektpropozimeve nga organizatat rinore është **9.600.000 Lekë**, nga i cili:

Shuma minimale për projektpropozim do të jetë 300.000 Lekë

Shuma maksimale për projektpropozim do të jetë 1.000.000 Lekë

- Totali i Grantit në dispozicion të projektpropozimeve nga organizatat për të rinjtë është **19,200,000 Lekë**, nga i cili:

Shuma minimale për projektpropozim do të jetë 1.000.000 Lekë

Shuma maksimale për projektpropozim do të jetë 3.000.000 Lekë

1.4 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e projektpropozimit për organizatat rinore dhe/ose për të Rinjtë do të jetë nga **6 muaj deri në 12 muaj**



1.5 Vendi i zbatimit

Projektet që do të mbështeten financiarisht nga ky Grant do të zbatohen kryesisht dhe ekskluzivisht në territorin e Republikës së Shqipërisë.

1.6 Bashkëfinancimi

Çdo aplikant ka të drejtën të marrë pjesë në projekt me bashkëfinancim.

2. Kualifikimi i aplikantit

2.1 Kjo thirrje shkon në mbështetje të të rinjve

Pjesëmarrja në këtë thirrje do të jetë transparente dhe e barabartë për të gjithë aplikantët organizata rinore dhe/ose për të rinjtë.

2.1.1 Të gjitha organizatat rinore aplikante, që do të përfitojnë mbështetje financiare nga kjo thirrje, duhet të plotësojnë kriteret më poshtë:

- a) Të jenë të regjistruara sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për organizatat jofitimprurëse;
- b) Të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës aktivitete dhe veprimtari rinore;
- c) Të paktën, 70 % e anëtarëve të saj të jenë të rinj;
- d) Të mos kenë detyrime tatimore;
- e) Të mos jenë në proces falimentimi ose likuidimi;
- f) Të mos jenë të dënuara organizata dhe përfaqësuesi i saj ligjor, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- g) Të kenë zbatuar, të paktën për një periudhë 2-vjeçare projekte e programe me impakt te të rinjtë.



2.1.2 Organizatat për të rinjtë, që do të përfitojnë mbështetje financiare, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;
- b) Të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës aktivitete dhe veprimtari rinore;
- c) Të kenë zbatuar, të paktën për një periudhë 3-vjeçare në mënyrë të vazhdueshme projekte e programe me impakt te të rinjtë;
- d) Të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;
- e) Të mos kenë detyrime tatimore;
- f) Të mos jenë të dënuar organizata dhe përfaqësuesi i saj ligjor, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

2.2 Projektet që financohen nga këto grante

Projektpropozimet që do të financohen nga kjo thirrje duhet të jenë të përgatitura në përputhje me thirrjen e parë publike të Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe prioritetet e përcaktuara në këtë thirrje.

Projektet duhet të përfshijnë veprimtari të integruara me impakt te të rinjtë dhe ti përmbahen prioritetëve të përcaktuara në këtë thirrje në mënyrë që të arrihen qëllimet e caktuara dhe rezultate specifike për një periudhë të kufizuar kohore.

2.3 Projektet që nuk financohen nga këto grante:

- Projekte në përkrahje të organizatave apo organizimeve politike apo aktiviteteve të jashtëligjshme;
- Fonde për blerje toke, godine, zyre;



- Projekte jashtë zonës së mbulimit të projektit në fjalë;
- Përfitime personale;
- Blerje pajisjesh (përveç rastet kur ato janë të nevojshme për zbatimin e projektit dhe nuk kalojnë më shumë se 25 % të buxhetit të kërkuar). Në raste të tilla pajisjet mbeten pronë e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, deri në momentin kur i dhurohen subjektit;

2.4 Dokumentat e nevojshme për të aplikuar:

- a) Formularin e aplikimit, ku të përshkruhet qartësisht qëllimi i projektit dhe veprimtaritë specifike që do të kryhen, në funksion të tij;
- b) Aktin e regjistrimit në gjykatë;
- c) Kopjen e statutit, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë zhvillimi i aktiviteteve rinore;
- d) Dokumentacionin që provon përvojë në zhvillimin e aktiviteteve rinore;
- e) Vërtetimin nga organet tatimore që i ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;
- f) Vërtetimin nga gjykata të 3 (tre) muajve të fundit se nuk është në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;
- g) Vërtetimin bankar të 3 (tre) muajve të fundit nga data e mbylljes së aplikimit;
- h) Vërtetim nga gjykata të 3 (tre) muajve të fundit që nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, organizata dhe përfaqësuesi i saj ligjor;
- i) Bilancin vjetor të tyre, si një kriter për të shpërndarë në mënyrë jo vetëm cilësore por dhe të drejtë grantin për financim;
- j) Projektpropozimin përkatës dhe/ose dokumentet shoqëruese të tij;
- k) Kalendarin e aktiviteteve të specifikuar me afate kohore;
- l) Plan-buxhetin;
- m) Deklaratën e konfliktit të interesit.



2.3 Informacion mbështetës

Me qëllim mbështetjen e të gjithë aplikantëve të interesuar, Agjencia Kombëtare e Rinisë në përputhje me kriteret e këtij udhëzuesi do të ofrojë informimin mbi këtë thirrje si më poshtë:

1. Përmes pyetjeve që mund të dërgohen në email-in zyrtar info@rinia.gov.al, përgjigjet e të cilave do të kthehen me shkrim po nga email-i zyrtar brenda 7 ditëve pune që nga data e regjistrimit të pyetjes përkatëse;
2. Përmes sesioneve informuese mbi thirrjen publike për të gjitha organizatat e interesuara për aplikime. Për shkak të pandemisë Covid-19 sesionet do të zhvillohen duke ju përmbajtur protokolleve përkatëse anti-Covid.

2.5 Afati i dorëzimit të aplikimeve dhe vendi i dorëzimit

Afati i dorëzimit të aplikimeve do të jetë 45 ditë kalendarike nga data e shpalljes së thirrjes. Afati i fundit për dorëzimin e projektpropozimeve është data 12/08/2021, ora 16:30.

Në kuadër të masave të marra për të parandaluar përhapjen e COVID-19, OJF-të janë të lutura që projektpropozimet të mos i dorëzojnë fizikisht pranë zyrave të AKR-së, por në dy variantet e mëposhtme:

a) nëpërmjet shërbimit postar publik apo privat në adresën: “Agjencia Kombëtare e Rinisë, Rruga Naim Frashëri, nr. 37, Tiranë, Shqipëri”

*Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të jenë shkruar emri i thirrjes publike për projektpropozime, emri i plotë dhe adresa e aplikantit, emri i plotë i projektit dhe fjalët: ”Zarfi të mos hapet përpara hapjes zyrtare”.



b) gjithashtu edhe **elektronikisht** vetëm në formatin e përcaktuar në adresën tonë elektronike: info@rinia.gov.al

**Në variantin elektronik nuk është e nevojshme firma dhe vula e skanuar.*

Të dyja variantet e aplikimit, si ai postar ashtu dhe ai elektronik duhet t'i përmbahen afatit të mësipërm.

** Çdo aplikim i dorëzuar pas këtij afati do të konsiderohet i pavlefshëm (do të merret në konsideratë data dhe ora e regjistruar në zyrat postare).*

** Asnjë aplikant nuk mund të aplikojë më shumë se një herë për të njëjtën thirrje*

** Kujdes! Aplikimet e paplota do të refuzohen automatikisht*

3. Vlerësimi dhe përzgjedhja e projektpropozimeve:

Procesi i shqyrtimit dhe përzgjedhjes së subjekteve përfituese, do të zhvillohet në dy faza nga AKR-ja dhe Bordi Përzgjedhës i Projekteve.

3.1 Faza e Parë:

Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të projektpropozimeve dhe subjekteve konkurruese do të kryhet nga AKR-ja. AKR gjatë kësaj faze vlerësimi ka për detyrë:

- a) Të administrojë aplikimet nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë;
- b) Të vlerësojë respektimin e parimeve dhe përmbushjen e kriterëve të subjekteve konkurruese dhe të projektpropozimeve, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;
- c) Të hartojë listën e projektpropozimeve, që plotësojnë kriteret, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga afati i fundit i dorëzimit të tyre;



3.2 Faza e Dytë

Përzgjedhja e projektpropozimeve, që plotësojnë kriteret dhe janë pjesë e listës sipas shkronjës "c", të pikës më sipër të këtij udhëzimi, bëhet nga Bordi Përzgjedhës i Projekteve, i cili ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë dhe ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për rininë.

Bordi bën përzgjedhjen e projektpropozimeve si projekte fituese dhe ka këto detyra:

- a) Hap, shqyrton dhe vlerëson kriteret e kualifikimit të projektpropozimeve të marra, në përputhje me kriteret dhe afatet e përcaktuara në dokumentet e konkurimit;
- b) Shpall rezultatet e konkurimit dhe vë në dijeni kandidatët pjesëmarrës për projektet jofituese, duke dhënë dhe arsyet përkatëse.

3.3 Publikimi i rezultateve

Publikimi i rezultateve të projekteve fituese do të bëhet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Rinisë www.rinia.gov.al si dhe përmes postës elektronike drejtuar të gjithë aplikantëve (fitues ose jo) përmes adresës zyrtare të AKR-së: info@rinia.gov.al

3.4 Ankimimi

Aplikuesi ka të drejtën e paraqitjes së një ankese, e cila dorëzohet jo më vonë se 10 ditë pune nga data e dërgimit të përgjigjes zyrtare.

Ankesa duhet të dërgohet me shkrim (e-mail ose postë) nga aplikanti dhe të përshkruajë arsyen e ankimimit. Përgjigja i dërgohet ankimuesit jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e njoftimit për ankim.

3.5 Tabela e vlerësimit

Vlerësimi bëhet në përputhje me projektpropozimin e paraqitur nga kandidati aplikues bazuar në kapacitetet e aplikantit, në efektshmërinë e aktiviteteve, pritshmërinë dhe koston e tyre.



4. Lidhja e Kontratës

Pas vlerësimeve të projektpropozimeve dhe shpalljes së projekteve fituese do të nisë lidhja e kontratave mes Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe organizatave të shpallura fituese brenda 30 (tridhjetë) diteve kalendarike nga data e njoftimit të rezultateve të konkurrimit.

Në kontratë përcaktohen: mënyra e transferimit të fondit, dokumentacioni dhe mënyra e raportimit financiar dhe performancës, llojet e shpenzimeve të njohura e të pranueshme, format e kontrollit, përfshirë detyrimin e subjektit përfitues për të vënë në dispozicion të Kontrollit të Lartë të Shtetit dokumentacionin për veprimtarinë financiare të kryer, mënyra e dokumentimit të shpenzimeve dhe rezultateve të projektpropozimit të financuar, si dhe kushtet apo përgjegjësitë e tjera të ndërsjella.

5. Raportimi

Raportimi i kandidatëve fitues do të bëhet pranë AKR-së në fund të çdo faze zbatimi, duke patur parasysh përcaktimet në kontratën e nënshkruar mes dy palëve, AKR dhe përfituesit të fondit.

Manuali për zbatimin e projekteve që përfshin mënyrën e raportimit financiar dhe narrativ do t'ju vihet në dispozicion të gjithë aplikantëve fitues nëpërmjet web-it zyrtar të AKR-së.

6. Monitorimi dhe Vlerësimi i Projektit

AKR-ja ka për detyrë të monitorojë projektet fituese dhe të vlerësojë realizimin e aktiviteteve të parashikuara në projekt brenda përcaktimeve të kontratës dhe në përmbushje të qëllimit dhe objektivave të paraqitura në projektpropozim.

** Formularin e aplikimit dhe listën e dokumentave të nevojshme për të aplikuar mund ta shkarkoni në faqen tonë zyrtare në adresën: www.rinia.gov.al.*